



Realizohet operacioni policor kundër trafikimit me qenie njerëzore, mbyllen nëntë lokale të natës

KRONIKA | August 27, 2022 - 15:06

SHPERNDAJE:  

Hetuesit nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (DHTQNJ), së bashku me njësitet tjera të PK-së dhe të Inspektorëve të punës, atyre të ATK-së e Inspektorëve komunal, gjatë ditës së premte kanë zbatuar Planin Operativ "Gushti 2022".

Sipas njoftimit të PK-së thuhet se gjatë realizimit të operacionit policor, janë kontrolluar 36 lokale të natës, ku nëntë lokale janë mbyllur nga inspektorët përkatës rreth parregullsive të hasura, raporton Zeri.info.

Po ashtu në njoftim thuhet se është gjetur një revole më katër fishekë dhe dy thika, janë iniciuar tri raste penale, është identifikuar në një lokal një viktimë e supozuar e trafikimit dhe janë legjitimuar 275 punëtorë të lokaleve (190 femra dhe 85 meshkuj).


Nërsa tutje në njoftim bëhet e ditur se 134 punëtorë janë me shtetësi të Shqipërisë, 132 shtetas të Kosovës dhe të tjerët nga vendet e rajonit (Maqedoni, Serbi e Bullgari).

Nëërkaq, policia do të vazhdojë aktivitet në luftën kundër veprimtarive antiligjore në përgjithësi dhe luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore në veçanti. /Zëri


Më të lexuarat

- 

KRONIKA |  August 25, 2022

Mërgimtari nga Gjermania rrah gruan sapo hyjnë në Kosovë
- 

KRONIKA |  August 25, 2022

Parashkruhet lënda e vrasjes së kryer nga hakmarrja para 33 viteve në Deçan
- 

KRONIKA |  August 25, 2022

Arrestohen pesë braziliane dhe tre kosovarë, dysohen për prostitucion
- 

KRONIKA |  August 25, 2022


Me 17-vjeçaren në bagazh tentoi të hyjë në Shqipëri, arrestohet 23-vjeçari
- 

KRONIKA |  August 26, 2022


Gjendet pa shenja jete një person në Pejë
- 

KRONIKA |  August 27, 2022


U alivanos derisa luante futboll, vdes një person në Klinë



Të rekomanduara

- 

Me 17-vjeçaren në bagazh tentoi të hyjë në...

 August 25, 2022
- 

Arrestohet një shtetas turk në aeroportin...

 August 25, 2022
- Ferizaj: Një punëtor lëndohet me substanca kimike në vendin e punës**

KRONIKA |  August 25, 2022
- Një person gjendet i vdekur në Istog, Policia nis hetimet**

KRONIKA |  August 25, 2022
- Mërgimtari nga Gjermania rrah gruan sapo hyjnë në Kosovë**

KRONIKA |  August 25, 2022
- Konfiskohet një armë në një aheng në Skenderaj**

KRONIKA |  August 25, 2022
- Policia sekuestron armë në një aheng në Malishevë**

KRONIKA |  August 24, 2022
- Tentoi të udhëtojë me pasaportë të huaj, shoqërohet në Polici një femër**

KRONIKA |  August 24, 2022